

## SPECIFIKIME TEKNIKE

### **Objekti: Mirembajtje makina mjete.**

Bashkia Gjirokaster kerkon te kryeje sherbimin e mirembajtjes se automjetete per vitin 2020 te:

- Bashkise Gjirokaster :
  - Agjencise se Sherbimeve Komunitare dhe Utilitare
  - Policia Bashkiake
  - Agjencise se sherbimeve bujqesore veterinare dhe mjedisore
  - Drejtoria e Arsimit
  - Drejtoria e mbrojties nga zjarri
1. Per te gjithë zerat e preventivit te hartuar per riparim mjetesh do te kryhen proceset e meposhteme :
    - Zmontimi i pjeses se kembimit te demtuar
    - Montimi i pjeses se kembimit te re
    - Kontrolli i funksionimit te pjeses se kembimit te re ne nyjen ose mekanizmin e vendosur
    - Te gjitha materialet dhe pjeset e kembimit qe do te zevendesohen do te jene pjese kembimi te reja dhe origjinale sipas tipit te automjetit .
    - Kontrolli i funksionimit ne teresi e mjetit,dhe prova me ngarkese.
  2. Servisi i operatorit ekonomik duhet të jetë i kompletuar me pajisjet e nevojshme për kryerjen e riparimeve dhe shërbimeve sipas tabelave të specifikimeve teknike te çdo automjeti.
  3. Operatori ekonomik fitues do të pranojë te kryeje kontrollin teknik të automjetit në çdo kohë. Riparimi dhe shërbimi i automjeteve do të bëhet menjëherë nga momenti i paraqitjes në servis. Koha e riparimit do te jete per riparimet xhenerike jo me shume se 3 (tre) dite ,per riparimet motorike jo me shume se 5 (pese) dite dhe per riparimet e tjera te sistemeve jo me shume se 2 ( dy) dite. Perjashtim bëhet vetëm në rastet e defekteve të renda për të cilat do të negociohet midis palëve kontraktuese.  
Si procedurë e kryerjes së përcaktimit të defektit do të jetë paraqitja e kërkesës- procesverbalit-marje dorëzim, te perbashket nga perfaqësuesit e autorizuar të Autoritetit Kontraktor, dhe nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik.
  4. Puna e kryer do të quhet e mirëqenë kur ajo do të miratohet me zëra dhe në cilësi nga përfaqësuesit Autoritetit Kontraktor (procesverbali dhe situacion i marrjes në dorëzim të automjetit si dhe fatura tatimore e firmosura nga palët kontraktuese).

Në rast të mosplotësimit të kohës së garancisë nga cilësia e keqe e pjesëve të montuara ose punës së kryer për montimin e tyre riparimi përsëritet me shpenzimet e Kontraktorit.

5. Personat përgjegjës për dorëzimin e automjeteve për kryerje të shërbimeve teknike do të jenë, sipas Urdhërit të Titullarit ose personit të autorizuar prej tij.

6. Personat përgjegjës për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve dhe për marrjen në dorëzimin të automjeteve të riparuar do të jenë sipas Urdhërit të Titullarit ose personit të autorizuar prej tij.

7. Operatori ekonomik është i detyruar që të përdor në procesin e riparimit pjesë këmbimi të reja dhe origjinale.

### **Specifikimi i Materialeve:**

Pjesët e këmbimit të jenë te reja dhe origjinale dhe në përshtatje me Markën dhe Tipin e automjetit (pa modifikime).

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

1. Mirembajtja dhe riparimet e automjeteve të kryhen në kohë dhe me cilësi të mirë.
2. Pjesët e këmbimit të jenë te reja , origjinale dhe në përshtatje me Markën dhe Tipin e automjetit (pa modifikime).
3. Pas çdo riparimi automjeti të shoqërohet me fletë garanci, me një afat kohor 6 (gjashtë) muaj nga data e kryerjes së riparimit, për riparimet xhenerike dhe 12 (dymbëdhjet) muaj për riparimet motorrike.
4. Pranimi i automjeteve për shërbim - riparim të shoqërohet me kërkesë - procesverbal-marje dorëzim te firmosur nga perfaqesuesit e autorizuar te AK dhe te pranuar nga operatorit ekonomik.

Emërtimi i shërbimit	Sasia për ekzekutim	Koha e realizimit	Vend i kryerjes	Mënyra e transportit
----------------------	---------------------	-------------------	-----------------	----------------------

Të Planifikuara	Sipas nevojës	brenda periudhës së kontratës	Servisi i operatorit ekonomik	Nga bashkia Gjjirokaster për mjetet që lëvizin normalisht. Nga operatori ekonomik për mjetet që nuk lëvizin normalisht.
Emergjente	Sipas emergjencës	Në çdo Kohë	Servisi i operatorit ekonomik	Nga bashkia Gjjirokaster për mjetet që lëvizin normalisht. Nga operatori ekonomik për mjetet që nuk lëvizin normalisht.

**Hartoi**

**Ing mekanik.Alfons Alikaj**